

Mergjyshi:Po punohet per te rrezuar Besen

nga Albaniassocer
E shtunë, 12 Prill 2014 16:23



Artan Mergjyshi, trajneri i Beses u tregua shume i zhgenjyer nga arbitrimi i ndeshjes se sotme. Kjo ndeshje ishte shume e rendesishme per ne sepse na duhej fitorja me doemos. Gjate gjithë kësaj jave është punuar kundër Beses. Është turp që po nënkembet një ekip me traditë si Besa. Gjithkund nëpër televizione në fusha e në korridorë ekipi jonë po shumëzohet me zeron. Tashmë është krijuar një vorbull që na ka tërhequr brenda dhe do të jetë e vështirë të dalim. Unë mendoj se 70% jemi të rene. Në ndeshjen e sotme u pa qartë që arbitrimi ishte tendencjuz. Ishin të pakten 4-5 kartona të kuqe për Laçin dhe një 3 penallti në favorin tonë. Qdo faull lojtaret e Laçit e rrethonin arbitrin duke i thënë fjale nga më të ndryshmet dhe kishte humbje kohë sistematike për të rifilluar lojën. Normalisht që edhe ekipi im gaboi shumë për portën sepse rastet i patëm por nervozizmi ishte i madh. Kur ka mungesë rezultatesh faji është edhe i trajnerit apo i stafit drejtues. Megjithatë me duket se po luftojmë kundër mullireve të ertes.